



Thirrje për pjesëmarrje në konferencë

Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike, njësi e përhershme e kërkim-studimit pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me rastin e 10-vjetorit të lumnimit të Nënë Terezës organizon konferencën shkencore ndërkombëtare *“Nënë Tereza dhe krishterimi ndër shqiptarë gjatë shek. XX”*, në datë **19 tetor 2026**.

Studiues, profesorë, doktorantë, kërkues në institucione akademike dhe kërkimore, specialistë të bibliografisë, filatelistë, arteve etj. si dhe gjithë të interesuarit ftohen të paraqesin kumtesat e tyre në tematikat e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm ndër to:

1. Nënë Tereza, shenjtore dhe nobeliste;
2. Poezia e Nënë Terezës;
3. Shenjtorët e botës shqiptare - nga krishterimi i hershëm deri sot;
4. Roli i krishterimit para, gjatë dhe pas Pavarësisë së Shqipërisë;
5. Religjioni në përgjithësi dhe krishterimi në veçanti në shtetin ateist;
6. Kisha katolike shqiptare gjatë totalitarizmit;
7. Ringritja e kishës katolike pas viteve 1990 dhe roli i Nënë Terezës.
8. Misioni i motrave të Nënë Terezës në Shqipëri.
9. Nënë Tereza dhe imazhi i saj artistik në kujtesën kolektive.

Punimet e Konferencës do të zhvillohen në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe italisht, në sallën “Aleks Buda”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Abstraktet (200-250 fjalë) mund të dërgohen pranë koordinatores së Konferencës, prof. as. dr. Teuta Toska në e-mailin ttoska@gmail.com deri me datë 25 shtator 2026.

Njoftimi për pranimin e abstrakteve do të bëhet brenda datës 10 tetor 2026 dhe shpërndarja e programit, me datë 15 tetor, 2026.